

**AKT THEMELIMI**  
**I SHOQËRISË TREGTARE**  
**" 99BROWN" SH.P.K ME SELI NË TIRANË**

\*\*\*\*\*

Sot, më datë 16/05/202, në Tiranë,

**Znj.Astia Doçi**, shtetase shqiptare e lindur më 07.07.1992 në Tiranë, Shqipëri, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me leternjoftim ID Nr. 038821924 me Nr. Personal J25707069H.

**Znj.Xhovana Doçi**, shtetase shqiptare e lindur më 16.10.1994 ne Tiranë, Shqipëri, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pashaporte me Nr. BE5831479 me Nr Personal J41016049L.

Të cilët kanë vendosur themelimin e shoqërisë **“99BROWN” SH.P.K** shoqëri tregtare me përgjegjësi të kufizuar, me termat e mëposhtme:

**NENI 1**

Shoqëria **“99BROWN” SH.P.K** është formuar si shoqëri tregtare sipas ligjit 9901 e datës 14/04/2008 "Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare", (në vazhdim Shoqëria).

Shoqëria ka selinë e saj në Tiranë dhe do të mund të vendosë ose heq seli sekondare, zyra sekondare përfaqesimi dhe agjenci në Shqipëri edhe jashtë shtetit.

**NENI 2**

**Emri i shoqërisë**

Shoqëria, do të dalë në qarkullimin juridiko - civil me emrin **“99BROWN” SH.P.K**

**NENI 3**

**Objekti i veprimtarisë**

Shoqëria ka për objekt në përputhje me kërkesat ligjore - veprimtaritë e mëposhtme:

**Startup ne fushen e prodhimeve të veshjeve nepermjet brand-it “99BROWN”, duke perdorur materiale te ricikluara, ekologjike dhe te biodegradueshme.**

Shitjen e produkteve “99BROWN”, nepermjet dyqaneve online dhe shperndarjes me poste.

Menaxhim i brand-it “99BROWN” dhe te drejtave te pronesise intelektuale qe burojne nga krijimtaria e brand-it.

#### **NENI 4**

##### **Selia e Shoqërisë**

Selia e Shoqërisë ndodhet në adresën: Rruga "Stavri Themeli", Nr.9, Nj. A 7, Tirane, Shqiperi.

#### **NENI 5**

##### **Kapitali i Shoqërisë**

Kapitali themeltar i shoqërisë do të jetë i përbërë nga kontributi i ortakëve themelues të kësaj Shoqërie në para në vlerën 100 (njëqind) lek, dhe është i ndarë në 2 kuota.

Themeluesit marrin në pronësi kuotat e tyre në kapitalin themeltar në përputhje me kontributin e tyre.

Kontributi i ortakëve themelues në kapitalin themeltar është si më poshtë:

**Znj.Astia Doçi** 1 kuotë, me vlerë 50 Lekë, zotëron 50%

**Znj.Xhovana Doçi** 1 kuotë, me vlerë 50 Lekë, zotëron 50%

#### **NENI 6**

##### **Kohëzgjatja e shoqërisë**

Shoqëria zhvillon aktivitetin e saj për një afat kohor të pacaktuar.

#### **NENI 7**

##### **Organet Drejtuese**

Duke ju referuar ligjit nr. 9901, datë 14/04/2008 "Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare", organet drejtuese të shoqërisë janë si më poshtë vijon:

1. Asambleja e Përgjithshme e Ortakëve;
2. Administratori.

Mënyra e organizimit të tyre dhe funksionimit është e përcaktuar në Statutin e Shoqërisë. Shoqëria do të administrohet fillimisht nga Administratori i vetem i cili zgjidhet me afat pesëvjeçar të ripërtërishëm përveç rasteve të revokimit ose të dorëheqjes ose shkaqeve të tjera ligjore.

Administratori i Shoqërisë i cili pranon do të jetë: **Znj.Xhovana Doçi**, shtetase shqiptare e lindur më 16.10.1994 ne Tiranë, Shqipëri, person madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar me pashaporte me Nr. BE5831479 me Nr Personal J41016049L.

Shoqëria përfaqësohet para çdo organi administrativ, gjyqësor, enti publik apo privat dhe në marrëdhënie me të tretët nga administratorët, të cilët i ushtrojnë këto të drejta në përputhje me Statutin e shoqërisë dhe legjislacionin në fuqi.

Shoqëria është e administruar nga një administrator i vetëm, edhe jo ortak ose nga shumë administrator, edhe jo ortak, sipas asaj që është përcaktuar në aktin e emërimit.

Kur administrimi i shoqërisë i është besuar disa personave, akti i emërimit vendos në alternative:

a) nëse administratorët do të veprojnë në mënyrë kolegjiale duke themeluar kështu këshillin e administrimit

b) nëse administrimi është caktuar bashkarisht ose jo bashkarisht.

#### **NENI 8**

Organizimi dhe funksionimi, i shoqërisë, ngritja e degëve apo filialeve të saj, do të bëhet në përputhje me dispozitat e ligjit përkatës dhe Statutit.

#### **NENI 9**

Të punësuarit dhe të ngarkuarit me drejtimin e Shoqërisë mbajnë përgjegjësi dhe detyrohen të zhdëmtojnë Shoqërinë për dëmet që i janë shkaktuar për faj të tyre gjatë ushtrimit të veprimtarisë së tyre.

#### **NENI 10**

#### **Ligji i aplikueshëm**

Veprimtaria e shoqërisë rregullohet nga rregullat e Statutit të firmosur nga ortakët themelues sipas parashikimeve të ligjit në fuqi në Republikën e Shqipërisë.

#### **NENI 11**

#### **Zgjidhja e mosmarrëveshjeve**


Mosmarrëveshjet që mund të lindin në lidhje me themelimin e Shoqërisë do të zgjidhen nga Ortakët, në rast të kundërt do të zgjidhen nga Gjykata e Rrethit Tiranë.

#### **NENI 12**

#### **Dispozitat përfundimtare**

Akt Themelimi hartohet në katër kopje në gjuhën shqipe dhe u lexua nga Ortakët Themelues, te cilët e gjetën atë në përputhje me vullnetin e tyre të lirë dhe e nënshkruan pa vërejtje.

#### **ORTAKËT THEMELUES**

Asho Doçi  


Khosana Doçi  
